




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
/KANCELARIJA PRESEĐNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

23/02/2024

Nr. i Protokollit: 02 / 107

Procesverbal nga Dëgjimi Publik me Qytetarë për Draft-Rregulloren Komunale për Transparency e dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparency 2024-2028, e mbajtur më 15 shkurt 2024, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Lulzim Sahiti, kryesues i grupit punues për hartimin e këtyre dokumenteve, zyrtarë komunal dhe qytetarë

Lulzim Sahiti: Përshëndetje për të gjithë! E kemi në diskutim publik Draft-Rregulloren Komunale për Transparency si dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparency 2024-2028. Këto janë dokumente mjaftë të rëndësishme që kanë për qëllim përcaktimin e rregullave që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencyn dhe llogaridhjen e organeve të Komunës sonë, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standartet minimale të konsultimit publik në Komunë me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore të Komunës si dhe obligimet e Komunës për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarëve.

Gjatë punës me Grupin Hartues të këtyre dy draf-dokumenteve, kuptohet gjithnjë në konsultim edhe me zyrtar të MAPL-së, kemi evidentuar disa plotësim-ndryshime në Draft-Rregulloren Komunale për Transparency.

Tek nen 5, paragrafi a ku thuhet: Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 2 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve duhet të jetë: Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Zyrës për Komunikim me Publikun, publikon njoftimin për mbledhje së paku 7 (shatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, 3 (tre) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente.

Te i njëtin nen, veçse te paragrafi b, ku thuhet: Të gjitha propozimet e komiteteve duhet të jetë: Të gjitha procesverbalet dhe raportet kurse fjala propozimet të hiqet.

Te neni 8, pika 1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtronen diskutimit publik duhet të jetë konsultimit publik, ndërsa fjala diskutimit të hiqet.

Përsëri te neni 8, pika 3, ku thuhet: Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje, duhet të jetë: Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit në bashkëpunim me zyrtarin për konsultime publike njofton palët e interesuara për konsultimin me shkrim dhe elektronik. Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban: Projekt-Propozimin për të cilin kërkoen komentet, adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike, informatat (emrin, mbiemrin dhe e-mailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe afatin për dorëzimin e komenteve.

Te neni 8, pika 5 e kemi edhe një ndryshim ku thuhet: Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve, duhet të jetë: Afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, për projekt-propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.

Te neni 9, ku thuhet: Përgjegjës për koordinimin e procesit te konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njësia/zyrtari për komunikim publik, duhet të jetë: Përgjegjës për koordinimin e procesit te konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar së bashku me zyrtarin përgjegjës për konsultime publike në koordinim me Zyrën për Komunikim me Publikun, kurse pjesa dhe njësia/zyrtari për komunikim publik hiqet krejt.

Ndërkaq te neni 11, pika 1.1. ku thuhet: Projekt-Planin Vjetor te Punës se Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit te Komunës/ ekzekutivit; (kjo pjesë duhet hiqet krejt).

Te neni 18, pika 3, ku thuhet: Aktet normative dhe vendimet e organeve të komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës, duhet të jetë: Aktet dhe dokumentet nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni publikohen nga njësia përgjegjëse për komunikim në komunë, në formë elektronike, në pajtim me dispozitat e legjislacionin, përkatësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Ndërkaq, tek Draft-Plani i Veprimit për Transparenë, në fq. 5 duhet të hiqet krej pjesa ku shkruan: Rregullore Nr.02/2012/MF për Tarifat në Qasje në Dokumente Publike.

Falemnderit shumë! Nëse ka dikush ndonjë pyetje lidhur me këtë dy Draft-Dokumente, jemi këtu t'u përgjigjemi!

Muhamet Hoxha: Vij nga Radio Zëri Shtimes, fillimi shpërndetje dhe falenderim për juve si inicues i këtyre rregulloreve dhe organizimin e këtij debati. Ajo që është më esenciale, e që neve po na dhemb si Shtime, është mënyra e organizimit të debateve publike. Pse debatet publike janë kaq të zbehta, a duhet të zhvillohen jasht syrit të publikut, e kjo jo me fajin e organizatorit. Nuk e di pse, a është krijuar një bindje që debatet publike organizohen së koti apo çka. Prandaj mendoj që edhe Zyra për Mardhënien me Publikun, përkatësisht shërbimi informativ, duhet të merret dhe të hulumtoj se si t'i përfitojmë qytetarët, ti kemi të pranishëm në debate sepse konsideroj që kontributi i tyre në debate publike është shumë i çmueshëm.

Sa i përket kësaj rregullore, unë shkurtimisht, pjesën kryesore do të fokusohem të mediat, meqë vij prej asaj fushe, mirë është që rregulloret që ju i parashtruat para nesh, mirëpo sa në fakt arrijnë të implementohen është një pyetje tjetër. Rreth transparencës në të kaluarën të komunës së Shtimes, unë kam një përvojë të gjatë, ju e dini, ka, ka pas dhe ka transparencë, posaqërisht me radion tonë, ne prej viti 2000, vazhdimisht jemi të pranishëm në të gjitha zhvillimet që ndodhin në komunën e Shtimes. Ne kemi edhe një marrëveshje të përbashkët me komunën e Shtimes, gjë që na obligon t'i përcjellim edhe kuvendet dhe zhvillimet që janë të specifikuara në atë marrëveshje. Çka është në esencë, diçka që po na mungon viteve të fundit, informimi në komunën e Shtimes, uebsajti e të gjitha ato, kanë funksionuar siç është më së miri, derisa kolegu Sahiti, ishte shef i informimit, që dua t'a falenderoj publikisht, jo vetëm për bashkëpunimin që ka pasur me radion tonë, por edhe për një informim të shpejt dhe të sakt, e jo të njëanshëm për publikun e gjerë. Dua të them, që faqja zyrtare e komunës ka qenë një dritare shumë e afërt me qytetarët shtimjan dhe ka plasuar secilën marrëveshje që është arrit në komunë. Tash egziston edhe facebook-u i komunës që përcjell gjitha ato që ndodhin në komunën tonë, natyrisht edhe sfidat me të cilat përballet jo vetëm komuna e Shtimes por edhe komunat e tjera. Çka është diçka jo në rregull, jo në rregull është që ngjarjet që ndodhin, ta marrim vetëm një mbledhje të kuvendit, pavarësisht që ajo transmetohet live, edhe ne e transmetojmë live në radio, ju e transmetoni në facebook të komunës, ne e japim raportin gazetaresk për atë mbledhje të kuvendit dhe nuk mjafton që publiku i gjerë të njoftohet me gjithë ato zhvillime të cilat ndodhin në kuvend. Pse, një pjesë e qytetarëve në kohën kur është transmetimi direkt, janë në angazhime ditore të punës, prandaj është e pamundur që ata ta ndijnë. Prandaj disa e shfrytëzojnë faqen e komunës ose facebook-un e komunës, e shkrimet të cilat publikohen, t'i lexojnë në kohën kur të pushojnë, pas orës 16 e në orët e mbrëmjes. Ipet një shkrim i rendit të ditës së mbledhjes, pa vendimet të cilat merren dhe kisha pas kërkesë që zyra për informim ti bëjë këto shkrime më gjerësisht.

Sa i takon radios tonë, kemi gjetur një bashkunim të mirë dhe jemi kuptuar midis dy institucioneve, këtë bashkëpunim ne e bëjmë vazhdimisht që 24 vite, dhe një praktikë që ka qenë më herët po na mungon, ajo praktika kur jemi ftuar për një vizitë psh të një ministri, atëherë kur është për media, për vizitë të një kryeministri, për një vizitë të një ndërkombëtarë dhe i kemi përcjellur, se ndryshe është kur e merr shkrimin prej facebook-u apo faqes së komunës dhe ndryshe kur e përcjell vet. Andaj viteve të fundit kjo po na mungon, ngjarjet ndodhin, ne si mediume nuk informohemi, ne si medium lokal që jemi të përhershëm në komunën e Shtimes, mos të flasim për mediumet qendrore që janë të stërngarkuara. Prandaj

kisha kërkuar një mirëkuptim nga Zyra e Informimit, që të n'a njoftojë me kohë, sepse nganjëherë nuk ka njoftime publike që ta zënë do të vijë ministri i MAPL-së, përveç rasteve të veçanta kur ata vijnë 1 orë përparrë dhe pa paralajmërim dhe e ralizojnë vizitën e tyre, e aj takim nuk është edhe i hapur e ndoshta edhe jo për media, prandaj nuk kemi as hatërbetje në këtë rast, mirpo në rastet tjera është mirë që kjo praktik të përdoret përshkak se edhe ne jemi afër publikut, afër dëgjuesve, ne punojmë për ta, ata janë gjyqtari suprem i yni dhe ne pa ta s'mund të mbijetojmë


Edhe një herë falemnderit juve, falemnderit komunës, ne jemi për bashkëpunim!

Lulzim Sahiti: Sa u takon pjesëmarrësve në dëgjime publike, ky është problem në nivel vendi, jo vetëm në komunën e Shtimes. Kemi pasur bisedime edhe me zyrtarë nga MAPL dhe zyrtarë të tjerë se cilat janë mënyrat më të mira, që qytetarët të marrin pjesë më shumë në dëgjime publike. Krejt kjo varet nga qytetarët, se sa e sheh ai të rëndësishme pjesëmarrjen, nëse është për buxhet, ose për probleme që ju takon lagjeve, ata vijnë vetveti se preket direkt qytetari. E përshebull me keëo Draft-dokumentet për Transparency, qytetarët nuk janë shumë të njojur me këtë lëmi edhe normal që ka më pak. Por pajtohem me ju, se sa më shumë qytetarë që kemi, është edhe interes i vet komunës, sepse çdo diskutim që del nga qytetari për ne është shumë më i mirë.

Kurse sa u takon ngjarjet e kuvendit që i përmende, ne kemi një zyre të vogël, kemi staf pak e punë shumë. Brenda asaj zyrës së informimit, e ki qasjen në dokumente publike, që zyra për informimi duhet me u përgjigj, i njejti zyrtarë duhet t'i kryej edhe konsultimet publike, i kemi edhe të dhënat personale. Pra është shumë e mbingarkuar zyra, e për këtë arsyesh herë jemi detyruar me shpejtësi ti qesim edhe ato informata. Në të kaluarën kemi pasur kohë më shumë dhe të falenderoj Muhamet për bashkëpunim, ndërsa tash mbledhjet përcillen edhe drejtpërdrejt, e kjo forma e përshkrimit është më shumë e mediave elektronike, radios, televizonit, të cilët në mbrëmje ata i transmetojnë.

Mefail Mustafa: Unë i përcjelli gjithmonë mbledhjet e kuvendit dhe mbledhjet e tjera dhe besoni që në këtë komunë janë më mirë se në Kuvendin e Kosovës. Por edhe unë kam një sygjerim, që vendimet që mirren në kuvend të shkruhen pak më gjërësisht. Për ndryshe gjithçka është perfekte.

Mbledhja përfundoi në ora 14:50



**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DEBATIN PUBLIK ME QYTETARË PËR
DRAFT-RREGULLOREN KOMUNALE PËR TRANSPARENCE DHE DRAFT-PLANIN E
VEPRIMIT PËR TRANSPARENCE KOMUNALE 2024-2028**

Shtime, më 15 shkurt 2024 (e enje)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Dukuriqe Xhemajli		
2	Rexha Ramic Zogaj	KK Shtime	
3	Sumniq Ahmeti	KK Shlime	
4	Diellza Aziqi	KK Shlime	
5	Vonica Zeqiri	KK. Shlime	
6	Ushqina Deliu		
7	Muhamed Hoxha	RZSH	
8	Skënder Dauti	SP. 1214514	
9	MEFHIL HUSI TAFI	OSCE	
10	LEUNITË AHMETI	DZH.E.	
11	Shqipe Viftani	Z. Jigone	
12	Sadberk Halili	KK - Shlime	
13	Valmire Hoxha	KK - shlime	
14	Dorjeta Gjoni	Zyra për Komunitetin me publikun	
15	Vlora Hyseni	Zyra për kom. me publikun	
16	Aleca Zecan	Gjyqtarit	
17	Gazmend Krasniqi	ARCHITKT	

